

FJALA E DEPUTETES LINDITA METALIAJ

E ENJTE 12 MAJ 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë që po na ndiqni,

Na është paraqitur sot për diskutim projektligji “Për ratifikimin e protokollit ndryshues të Konventës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale”. Por sapo përmendim fjalinë “për mbrojtjen e të dhënave personale”, shqiptarëve u kujtohet menjëherë skandali me patronazhistët, me njerëzit e punësuar e të paguar për të survejuar, kontrolluar dhe spiunuar shqiptarët në përditshmërinë e tyre, duke u marrë të dhënat personale: vendin ku punojnë, banesën ku jetojnë, pagat e tyre, bizneset, targat e automjeteve dhe çdo gjë tjetër që u nevojitej patronazhistëve gjatë fushatës zgjedhore të 25 prillit.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj publikimin e të dhënave personale të 910 mijë qytetarëve, publikimin e të dhënave 637 mijë qytetarëve për muajt janar-prill 2021; publikimin e targave të 530 mijë qytetarëve. E kanë bërë këtë duke përdorur institucionet e shtetit, duke përdorur e-Albania-n, hipotekat, legalizimet, shërbimet e transportit rrugor dhe çdo institucion tjetër shtetëror. Në një vend ku mbledhja, përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale të qytetarëve në mënyrë të paligjshme është bërë pothuajse normale, rezulton se asnjë drejtues, zyrtar apo përfaqësues i lartë i institucioneve publike të ketë mbajtur përgjegjësi administrative apo penale. Të dhënat personale janë të dhëna që qytetarët ua kanë besuar institucioneve shtetërore, ndërkohë që ato u përdorën për qëllime kriminale, për t’i intimiduar, frikësuar, për t’u bërë presion zgjedhësve gjatë fushatës zgjedhore të 25 prillit.

Këto fakte i denoncoi jo vetëm Partia Demokratike, por edhe raporti final i OSBE/ODIHR-it, raporti i Transparency International dhe ai i Departamentit Amerikan të Shtetit, të cilët denoncuan me forcë rrjedhjen e të dhënave sensitive në prag të zgjedhjeve elektorale të 25 prillit dhe nënvizuan me forcë partinë-shtet. Lidhur me këtë skemë tërësisht kriminale dhe të paligjshme, jo vetëm që nuk ka pasur hetime të plota dhe të gjithanshme për nxjerrjen e përgjegjësve përpara ligjit, por organet e drejtësisë vrapuan menjëherë për të sekuestruar pajisjet e Lapsi.al, çka detyroi Gjykatën e Strasburgut të merrte një vendim të rrallë për ndalimin e veprimeve që cenonin lirinë e shtypit.

Nga ana tjetër, Kryeministri Rama dhe drejtuesit më të lartë të Partisë Socialiste falënderuan patronazhistët, të cilët ishin personat që administrojnë dhe furnizojnë me të dhëna këtë sistem kriminal. Çdo të thotë kjo? Padyshim që nënkupton se ka qenë një projekt qeveritar, një krim qeveritar, me model të diktaturave komuniste, ku njeriu survejohet dhe kontrollohet. Shqiptarët presin që shteti të jetë garantuesi i të drejtave dhe të dhënave të tyre personale nga operacionet e krimit dhe të hakerave, por ne jemi në një situatë ku vetë shteti kërcënon sigurinë e të dhënave personale dhe i përdor ato për interesat e partisë - shtet. Në fakt, qeveria shqiptare e ka shkelur këtë parim duke abuzuar me të dhënat personale.

Prandaj, ne mund të ratifikojmë çdo konventë e të miratojmë çdo ligj, por nëse nuk zbatohet dhe nëse nuk i përmbush qëllimet për të cilat miratohet, ai mbetet thjesht në letër dhe vetëm kaq. Ndaj, i bëj thirrje këtij parlament të marrë një angazhim serioz dhe të përdorë të gjithë forcën që i dikton ligji për të kontrolluar qeverinë, për të mbrojtur shqiptarët, të dhënat e tyre dhe privatësinë e tyre. Duhet ta bëjmë këtë nëse duam ta vendosim këtë shtet në shinat e shtetit të së drejtës. Gjithashtu, do të doja që, në kuadër të sigurisë kombëtare, parlamenti ta ushtronte pushtetin e tij edhe në luftën kundër lëndëve narkotike. Të mos heshtim, por ta ngremë zërin së bashku, të djathtë e të majtë, pozitë dhe opozitë, sepse çdo ditë që kalon do të jetë vonë. Në qarkun e Lezhës po mbillet përsëri kanabis, si në ambiente të mbyllura, në serra, por edhe në parcela, madje mund të them se kultivimi i kanabisit nuk është ndaluar asnjëherë dhe askush nuk flet. Askush nuk flet publikisht nga frika dhe kërcënimi.

Në vend që të thellohet lufta kundër këtij krimi, ndërkohën ata që flasin dhe e ngrenë si problem. A nuk e ka kuptuar ky parlament dhe kjo qeveri se çfarë pasojash sjell kultivimi i drogës? Nëse i kanë harruar, po ua kujtoj për të disatën herë. Kultivimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike krijojnë familje kriminale, grupime kriminale dhe organizata kriminale, me shumë para, me shumë prona dhe me kapacitet për të paguar dhe blerë zyrtarët e shtetit, për të blerë gjyqtarë, prokurorë, oficerë të policisë, gazetarë, media dhe gjithçka që u del përpara. Kjo na çon në situatën që ata vrasin dhe nuk dënohen, që mbyllën hetimet, që ndërpritet gjykimi, që jepen vendime të padrejta, sepse kanë shumë para për të paguar, na çon në situatën kur këto familje, grupe dhe organizata kriminale, dhunojnë dhe terrorizojnë fshatra të tërë, dhunojnë dhe terrorizojnë qytete dhe komunitete të tëra, sepse nuk ka kush t'i ndalojë.

Policia, që duhet t'i ndalonte, bëhet aleati i tyre dhe qytetarët kanë frikë t'i denoncojnë, pasi askush nuk i mbron. Kriminelët e paguajnë shtetin dhe në shumë raste janë vetë shteti. Kultivimi dhe trafikimi i drogës na çon në situatën kur në zgjedhjet për bashkitë dhe parlamentin, familje, grupime dhe organizata kriminale kandidojnë ose nxjerrin kandidatët e tyre, blejnë vota, blejnë komisionerët e

partive rivale, dhe marrin mandate të blera. Kështu, bëhen pjesë integrale e shtetit. Ky infiltrim i elementit kriminal në shtet është shqetësim i ngritur në mënyrë të përsëritur nga Partia Demokratike, në shërbim të rendit dhe të sigurisë në vend, por edhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, sepse është kërcënim edhe për sigurinë e Aleancës.

Pra kultivimi dhe trafikimi i drogës sjellin dëme në disa komponentë të rëndësishëm: shkatërron tregun e lirë dhe ekonominë, sepse krijon pasuri të pabarabartë; shkatërron administratën publike, sepse infiltrohen ushtarë të blerë prej tyre; shkatërron drejtësinë, sepse blihen prokurorët dhe gjyqtarët; shkatërron demokracinë, sepse blihen zgjedhjet; shkatërron median, sepse me paratë e krimit blihen mediat. Mund të themi me zë të lartë se kultivimi dhe trafikimi i drogës praktikisht sjell diktaturën. Ndaj, në këtë parlament unë flas në emër të atyre qytetarëve që nuk duan të degradojnë më thellë në diktaturë dhe të nënshtrohen, përkundrazi, duan të jetojnë të lirë. Një shqetësim tjetër në planin e sigurisë kombëtare është edhe siguria rrugore.

Kushdo që viziton Shqipërinë, skandalizohet nga kaosi rrugor, nga mungesa e parametrave të rrugëve, nga mungesa e sinjalistikës dhe nga mungesa e elementeve minimale të sigurisë. Pse e them këtë? Rrugët e qarkut të Lezhës janë burim aksidentesh. Konkretisht, në superstradën Laç – Lezhë dhe Lezhë - Shkodër çdo ditë shënohen aksidente me pasoja të rënda, shpeshherë, fatkeqësisht, edhe me humbje jete. Po ashtu, kryqëzimi i Rilës dhe i Shënkollit janë nyjet me problematike sa u takon aksidenteve, pasi drejtuesit e mjeteve që dalin nga rrugët dytësore nuk kanë fushëpamje të plotë të rrugës për shkak të mbrojtëseve të urës. Ndaj, i kërkoj qeverisë të vërë dorë në këtë drejtim. Pa dyshim, krimi, droga dhe skandalet e mëdha i kanë dhënë mjaft anë të errëta Shqipërisë, por tani i shtohen edhe aksidentet e vendasve dhe të huajve nga papërgjegjshmëria e institucioneve ligjzbatuese dhe nga lajthitjet e të fortëve të rrugëve.

Nuk kërkohet shumë, nuk është ndonjë projekt për të pushtuar planetë të tjerë dhe ne nuk i kemi mundësitë, por thjesht ka munguar dëshira dhe përkushtimi, sepse rregullimi dhe standardizimi i parametrave rrugorë është brenda mundësive dhe kapaciteteve të shtetit shqiptar. Kjo mungesë vullneti po kushton jetë njerëzish. Kjo për sa u përket përgjegjësive qeveritare. Për sa u përket drejtuesve të mjeteve dhe përdoruesve të rrugës, dua t'u bëj një apel dhe t'u lutem: ecni me kujdes! Makina në vetvete, sikurse është mjet transporti, njëkohësisht shndërrohet edhe në një armë në duart tuaja, që mund t'ju vrasë ju dhe të tjerët, nëse nuk drejtohet me kujdes brenda rregullave të qarkullimit rrugor. Ndaj, ju lutem, ecni me kujdes, sepse askush nuk është i tepërt në këtë botë! Nga një pakujdesi dhe vetëbesim i tepruar, mund të shkaktohen tragjedi e drama familjare. Faleminderit!